



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:107260

Datë: 15.08.2024

Numri i dokumentit: 06054736

Në ankesën e

AC-I-24-0163

1. S1 S,

Paditësit/Ankuesit

2. M1 S,

3. Xh S,

4. A S,

5. S2 S L,

6. S3 S F, të gjithë nga Prizreni, të cilët i përfaqëson avokati Xh O, nga Prizreni dhe avokat E G, nga Prizreni, Prizren.

Kundër:

E paditura

KBI "Progres Eksport-Lavërtaria/Blegtoria", Prizren e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr. sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Manushe Karaqi dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve të parashtruar kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-III-17-0029, të datës 09 shkurt 2024 në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 15 gusht 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësve refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-17-0029, i datës 09 shkurt 2024.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 24 mars 2006, paditësit e parashtruan një padi pronësore në Gjykatën Komunale në Prizren, me të cilën ata kërkuan, vërtetimin e të drejtës pronësore për ngastrën kadastrale nr..vendin e quajtur "G", arë, klasi i -III-, në sipërfaqe prej 0.59,94 ha, e evidentuar në Fletën poseduese nr., Zyra kadastrale Prizren.

Paditësit në padi kanë pohuar se paraardhësi i tyre, gjyshi i ndjerë M2 S nëpërmjet të Kontratës së shitblerjes ka blerë pronën e cekur më lartë. Pas vdekjes së tij prona trashëgohet nga i biri i ndjerë H S. Tutje paditësit pohuan se ata janë trashëgimtarët e të ndjerit H S. Bashkë me padi paditësit kanë bashkëngjitur: Kontratën e shitblerjes nr., leg. të datës.. e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren, Certifikatën e vdekjes së M2 S dhe të H S si dhe Certifikatat e lindjes të gjithë paditësve dhe Certifikatën pronësore të vitit 2006, sipas së cilës prona kontestuese evidentohet në emër të KBI "Progres Export", Prizren. Kjo lëndë evidentohet me numër C.nr.226/06.

Me datë 09 mars 2009, NSH ja e paditur KBI "Progres Eksport" ka dorëzuar përgjigjen në padi. Në përgjigjen në padi përfaqësuesi i NSH-së pohon se paditësit kanë deponuar si dëshmi kontratën mbi shitblerjen të lidhur në mes të shitësit F N M nga fshati S , KK Prizren dhe blerësit M2 S nga Prizreni, Leg.nr..të datës... Nga provat e përmendura, nuk ka dëshmi se në çfarë bazë kjo pronë është e evidentuar në emër të KBI "Porgres Eksport" në Prizren. Tutje në përgjigjen në padi, e paditura kanë kërkuar që të refuzohet padia si e pa bazuar, pasi që nuk ekziston legjitimiteti pasiv në anën e të paditurës.

Me datë 19 tetor 2010, Gjykata Komunale në Prizren me Aktgjykim C.nr. 226/06 e refuzon si të pa bazuar padinë e paditësve. Gjykata Komunale në Prizren ka arsyetuar se eksperti i gjeodezisë R S në konstatimin e vet të datës 21 maj 2009, ka theksuar se nuk ka mund të jap gjenezën – historinë për ngastrën kadastrale të cekur, ndërsa ka konstatuar se kontrata Leg.nr., me të cilën kjo pronë ka kaluar në emër të NSH-së nuk ekziston në kadastër për shkak të zjarrit që ka ndodhur në vitin 2007, me ç`rast është shkatërruar tërë arkiva e aparatit kadastral.

Me datë 16 mars 2011, i autorizuari i paditësve parashtrroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr. 226/06 të datës 19 tetor 2010, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Paditësit kërkuan aprovimin e ankesës si të bazuar, prishjen e Aktgjykimit ankimor, dhe kthimin e çështjes në rivendosje. Lënda, pastaj evidentohet në Gjykatën e Qarkut në Prizren me numrin, AC.nr.20/2012.

Me datë 23 maj 2012, Gjyqtari përgjegjës i lëndës i Gjykatës së Qarkut në Prizren, nëpërmjet aktit përcjellës, e dërgon lëndën në DHPGJS si Gjykatë kompetente për vendosje. Në DHPGJS, lënda evidentohet me numër C-III-12-0924.

Me urdhër të brendshëm të gjyqtarit përgjegjës të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, lënda referohet për Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, dhe pastaj kjo lëndë regjistrohet me numrin AC-II-16-0016.

Me datë 15 nëntor 2016, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtrësë dhe përgjigjet në ankesën e paditësve. Në këtë parashtrësë AKP-ja i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të paditësve dhe ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 16 shkurt 2017, Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-II-16-0016, e aprovon ankesën e paditësve si të bazuar, e prish Aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Komunale në Prizren, dhe padinë e paditësve e dërgon për shqyrtim në Kolegjin përkatës të specializuar të DHPGJS-së. Kolegji i Apelit ka arsyetuar se Aktgjykimi i ankimuar është lëshuar nga Gjykata Komunale, Prizren pa kompetencë lëndore. Në bazë të nenit 4 paragrafi 1.11, të Ligjit të Dhomës së Posaçme, Dhoma e Posaçme

ka kompetencë ekskluzive në rastin konkret, dhe është e obliguar që të vlerësoj ligjshmërinë e një aktgjykim apo aktvendimi të lëshuar nga një gjykatë tjetër në Kosovë, lidhur me kërkesat apo lëndët e përcaktuara me këtë paragraf. Ndërkaq, në bazë të paragrafit 4 paragrafi 2 i Rregullores së UNMIK-ut, që ishte e zbatueshme në kohën e nxjerrjes së Aktgjykimeve kontestuese, asnjë Gjykatë në Kosovë nuk mund të ushtroj juridiksion për paditë apo të zgjidh rastet që përfshinë lëndët e përshkruara në nenin 4.1(që ka të bëjë me kompetencën primare), përveçse nëse një padi e tillë i është referuar asaj gjykate në pajtim me këtë nen. Tutje Kolegji i Apelit konstaton se kjo padi nuk ishte e referuar nga Dhoma e Posaçme asnjëherë, dhe rrjedhimisht kjo Gjykatë kishte vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë në zbatim në Dhomën e Posaçme, dhe në kundërshtim me nenin 182, paragrafi 2, pika (f) e LPK-së.

Pas kthimi të lëndës në rigjykim, lënda regjistrohet me numrin C-III-17-0029.

Me datë 22 shtator 2022, Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së ka lëshuar një urdhër për paditësit dhe për AKP-në. Me këtë urdhër nga paditësit është kërkuar të japin sqarime shtesë për legjitimitetin aktiv dhe pasiv, u janë kërkuar edhe provat se paraardhësi i tyre a ka qenë i regjistruar si pronar ndonjëherë, sikur i ju është kërkuar edhe një liste e provave. Ndërsa me këtë Urdhër AKP-së i është kërkuar që ajo të jap sqarime se si është regjistruar ngastra lëndore në emër të NSH-së, pastaj të deklarohet se a ' ka libra pronësor, kush është në posedim të pronës.

Me datë 14 tetor 2022, i autorizuari i paditësve e ka dorëzuar një parashtresë si përgjigje ndaj urdhrit. Me këtë parashtresë ka dorëzuar dëshminë e vdekjes për H M2 S, ndërsa nuk ka dorëzuar dëshminë e vdekjes për M2 S. Në dëshminë e vdekjes për H M2 S janë shënuar si trashëgimtar: Sh Si – Bashkëshortja , S S i biri, M S, Xh S dhe A S. I autorizuari i paditësve ka bashkangjitur një autorizim për Sh S, dt 14.10.2022 ku ne vend të nënshkrimit është vënë shenja e gishtit pa u konstatuar fare në dokument se shenja e gishtit në prezencën e kujt është vendos, pa u shënuar fare se i është lexuar autorizimi dhe a' e ka kuptuar përmbajtjen e autorizimit. Ky autorizim është hartuar nga avokati E G, më dt. 11.10.2022, në fakt Sh S i nuk është përfshirë në padi si paditëse dhe nuk janë dhënë arsyet edhe pse ajo siç pretendohet paska lëshuar autorizim për avokatin.

Me datë 17 tetor 2022, AKP-ja ka dorëzuar një parashtresë si përgjigje ndaj urdhrin. Në këtë parashtresë AKP-ja është deklaruar se paditësve i mungon legjitimiteti aktiv. Në parashtresë është deklaruar NSH-ja nuk ka Libra të pronës pastaj nuk është paguar tatimi në pronë pas luftës, dhe se ngastra lëndore nuk është privatizuar. Në parashtresë AKP-ja është deklaruar edhe në supozim se prona ka kaluar pa ndonjë bazë ligjore tek NSH-ja, sipas nenin 268, të Ligjit të punës së bashkuar, Gazeta zyrtare e RSFJ 53/76, është paraparë „nëse palujatshmeria është bërë mjet në pronësi shoqërore pa bazë juridike , kthimi i saj mund të kërkohet në afatin prej 5 vjetësh, duke filluar nga dita e njoftimit, kurse më së voni në afatin prej 10 vitesh “. Kështu që mbi këtë bazë juridike është parashkruar kërkesa. Bashkë me parashtresën AKP-ja ka bashkangjitur provat të cilat ekzistojnë në shkresa të lëndës si raporti i ekspertizës.

Me datë 18 korrik 2023, Kolegji i Shkallës së I-rë lëshoj edhe një urdhër për paditësin ashtu edhe për të paditurën, me të cilën është kërkuar që të plotësohet ekspertiza gjeodezike.

Me datë 07 gusht 2023, i autorizuari i paditësve ka dorëzuar një parashtresë ku ka bashkangjitur edhe ekspertizën e ekspertit D B, por prapë i njëjti nuk ka vepruar sipas urdhrin të datës 22 shtator 2023. Me ekspertizë të ekspertit të datës 26.07.2023, është identifikuar gjendja faktike në teren në ngastrën lëndore., dhe sipas të njëjtës është konstatuar se në ngastër nuk ka objekt të ndërtuar, ngastra është rrethekuar me kufij natyror. Nga ana jugore është e kufizuar me rrugë publike e cila është e shtruar me kubza, dhe kjo rrugë mban emrin Rr. „,“, për këtë gjendje ka ofrua edhe fotografi ,pastaj fotografi nga gjeoportali, dhe sipas ekspertit ngastra nga ana veriore kufizohet me ngastrat, nr., .. në anën lëndore me ngastrën nr., në anën jugore me rrugën publike dhe në anën perëndimore me ngastrën nr..

Më datë 16 janar 2024, është mbajtur seanca dëgjimore për padinë. Në seancë dëgjimore i autorizuari i paditësve është deklaruar: mbes pranë kërkesëpadisë, thënieve në shqyrtimet e mbajtura deri më tani, në parashtresa të dorëzuara nga ana e kolegut tim , propozoi të aprovohet kërkesëpadia. Për AKP-në, përfaqësuesi është deklaruar: i kundërshtojmë të gjitha pretendimet e palës paditëse dhe mbesin pan kundërshtimit në legjitimitetin aktiv të palës në kundërshtimin e parashkrimit të kërkesës.

Gjyqtari kryesues pas administrimit të provave, palëve ndërgjyqës ju dha afati prej 15 ditëve ti parashtronjë parashtrësat me fjalë përfundimtare.

Më datë 25 janar 2024, AKP-ja ka dorëzuar fjalën përfundimtare me shkrim, duke theksuar se paditësit nuk kanë provuar legjitimitetin e plotë aktiv në kërkesën e tyre, pasi nuk kanë dorëzuar vendim trashëgimor. Më tej ka theksuar se paditësit, kanë qenë shumë pasiv të pa interesuar në kërkesën e tyre pasi nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim ligjor për realizimin e saj me kohë. Paditësit në rastin konkret ata duhet të provojnë me prova se janë pronarë të ngastrës dhe si pronar edhe të kërkojnë dorëzimin e pronës në posedim. Po ashtu nuk ka prova se paraardhësit e paditësve të kenë kërkuar këtë pronë ndonjëherë. Edhe në supozim se ngastra lëndore ka kaluar pa ndonjë bazë ligjore, sipas nenit 268 të Ligjit për punën e bashkuar kërkesa e paditësve është parashkruar. Bazuar në ekspertizë gjeodezike ngastra lëndore është regjistruar në emër të KBI „Progres Export“ nga baza e kontratës së shitblerjes nr.. AKP-ja në fjalën përfundimtare ka kërkuar të refuzohet kërkesëpadia si e pa bazuar .

Më datë 24 janar 2024, për paditësit avokati E G ka dorëzuar fjalën përfundimtare me shkrim, ku është deklaruar se duke u mbështetur në provën e ekspertizës së ekspertit R S, është dhënë historiat i pronës, pastaj eksperti ka dal në vendin e ngjarjes, dhe se edhe me ekspertizë të ekspertit D B është identifikuar ngastra lëndore . Më tej ka theksuar se në vitin 1969, kjo pronë pa bazë juridike ka kaluar në emër të KBI „Progres Export“, mirëpo paditësit kanë vazhduar ta punojnë, tokën pa pengesa, nga askush, dhe se prona kufizohet me prona private, dhe nuk ka asnjë lidhje me prona shoqërore, dhe se të gjitha parakushtet janë që padia të aprovohet si e bazuar.

Me datë 09 shkurt 2024, Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së me Aktgjykimin C-III-17-0029, e refuzon padinë e paditësve si të pa bazuar. Kolegji i Shkallës së I-rë ka arsyetuar se Gjykata konstaton se në mes palëve ndërgjyqës objekti i kontestit është ngastra kadastrale.,ZK Prizren, me kulturë arë, klasa 3, me sipërfaqe 59,94m2, e regjistruar në emër të KBI Progres. Kjo ngastër është identifikuar nga ekspertet e gjeodezisë. Kolegji i shkallës së I-rë konstaton se paditësit nuk kanë dorëzuar ndonjë provë që vërteton legjitimitetin e plotë aktiv si paditës, përkundër

urdhrit C- III-17- 0029, dt. 22.09.2022, të cilin Urdhër e ka pranuar avokati E G më dt. 06.10.2022. Tutje Kolegji i shkallës së I-rë konstaton se në fakt paditësit kanë dorëzuar dëshminë e vdekjes për H M2 S, e hartuar më dt. 05.05.20215 nga Regjistri Civil, sipas të cilës i ndjeri kishte lindur më dt. 01.04.1928, ndërsa kishte vdekur më dt. 28.03.2001, duke lënë Bashkëshorten Sh S , fëmijët : S, M, Xh dhe A, ndërsa nuk ka dorëzuar dëshminë e vdekjes për M2 S i lindur më datë 02.04.1906, ka vdekur më dt. 14.12.1979, se kënd ky e ka lan pas vete përpos H. Me provën e ekspertit të gjeodezisë,R S është konstatuar se ngastra lëndore .., në vendin e quajtur ,, G '' , arë klasa e tretë, me sipërfaqe 59,94ha, ka qenë e evidentuar në emër të M2 (Sh) S deri në vitin 1969, kur në bazë të kontratës së shitblerjes 789/69, kjo pronë ka kaluar në emër të KBI Progres. Eksperti në shkresa të lëndes ka pasur edhe një kontratë të lidhur në mes F N M, nga S e P e si shitës edhe M2 S nga Prizreni, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren Vr., dt., si blerës, dhe objekti i shitblerjes është ngastra nr. .., fleta e posedimit.. Në këtë kontratë shitësin e kishte përfaqësuar me autorizim H K nga Prizreni me banim në Beograd, dhe shuma e parave prej 15 mij dinarë ju ishte dorëzuar H K. Në rastin konkret konstatimi në ekspertizë nga ekspertit R S, sipas të cilit kjo pronë ka qenë pronë e M2 Sh S nga Prizreni deri në vitin 1969, është shumë kundërthënëse, edhe me vetë faktin kur thotë se ngastra deri në vitin 1969 ka qenë pronë e M S, ndërsa i njëjti këtë pronë e kishte blerë me kontratë nga ish pronari F N M, në vitin 1970. Pavarësisht nga fakti se kontrata e vitit 1969 është thënë se është djegur për shkak të zjarrit në objektin e Komunës, eksperti nuk është deklaruar fare në burimin e informatës për një konstatim të tillë se prona ka qenë në emër të M2 S, deri në vitin 1969. Tutje Kolegji i shkallës së I-rë konstaton se sipas konstatimit në arsyetim të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 226/06, dt. 19.10.2010, në arsyetim të vendimit faqja e dytë, është thënë se Kontrata e shitblerjes nr. 789/69, bazuar në raportin e me shkrim të arkivistit të gjykatës I D, numri i legalizuar i kontratës leg., dt., është lidhur kontrata mbi ndërrimin e paluajtshmëve ndërmjet personave tjerë dhe atë në mes personit M dhe personit me emër dhe mbiemër të pa lexuar. Pra në rastin konkret paditësit nuk kanë provuar faktin që paraardhësi i tyre me KBI Progres të ketë pasur ndonjë kontratë /punë juridike . Sikundër që paraardhësi i paditësve të ketë qenë pronar i ngastrës para vitit 1970. Në rastin konkret gjykata vlerëson se paditësit përveç që nuk kanë provuar faktin se paraardhësi i tyre (gjyshi) kënd e ka lënë si trashëgimtar të vetin , përveç H S, ata kanë dështuar edhe të provojnë edhe faktin për çfarë arsye M2 S ka lidhur

kontratë të shitblerjes me F M në vitin 1970, ndërsa para vitit 1970, kush ishte pronarë i ngastrës. Gjykata vlerëson se paditësit në padinë e tyre qartazi nuk e kanë treguar asnjëherë bazën juridike të kërkesës për fitimin e pronësisë për ngastrën lëndore, sikundër të njëjtit përkundër faktin se kanë pasur avokat profesionist, ata kanë dështuar që me prova të argumentojnë se nga cila bazë juridike ka kaluar kjo pronë në emër të NSH-së, ose ata këtë fakt e dinë por nuk e kanë treguar, pastaj për çfarë arsye paraardhësi i tyre nuk e ka ushtruar kërkesë për regjistrimin- bartjen e pronësisë nga F M te M2 S. Në rastin konkret në bazë të provave, vërtetohet fakti se paraardhësi i paditësve nuk ka qenë në raport juridike me NSH-në. Kolegji i shkallës së I-rë vlerëson se në rastin konkret paditësit të cilët kanë qenë në posedim të ngastrës, ata e kanë ditur, se ngastra lëndore është pronë e NSH „ Progres Export ”, dhe se në rastin konkret të njëjtit nuk mund ta kenë cilësinë e poseduesit me mirëbesim. Gjykata një vlerësim të tillë e mbështet në nenin 72 paragrafi 2, i Ligjit Themelorë Për Marrëdhëniet Juridiko Pronësore i vitit 1980 që parasheh „ Posedimi është me mirëbesim po që se mbajtësi nuk e di ose nuk ka mundur të dijë se sendin që e mban nuk është i tij ”. Kolegji i shkallës së I-rë konstaton se duke marrë për bazë provat të cilat palët i kanë dorëzuar për të argumentuar pretendimet e tyre faktike dhe juridike, në rastin konkret paditësit me asnjë provë nuk kanë argumentuar sipas parimit të barrës së provës, se të njëjtit e kanë fituar të drejtën e bashkëpronësisë në ngastrën lëndore.

Me datë 27 shkurt 2024, paditësit për mes postës e kanë dërguar një ankesë në DHPGJS kundër Aktgjykimit të Kolegjit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-17-0029 të datës 09 shkurt 2024, për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkojnë nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar, ose të priset Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim. Për më tepër në ankesë paditësit kanë pretenduar se Aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, për të cilat Kolegji i Apelit ex officio duhet të kujdeset. Paditësit kanë pohuar se në këtë çështje kontestuese, është kryer ekspertiza gjeodezike, për mes së cilës është bërë identifikimi dhe është bërë matja, duke dhënë gjendjen ekzistuese, andaj ka bazë ligjore që padia të aprovohet si e bazuar. Tutje paditësit pohojnë se lidhur me ngastrën., ZK Prizren në sipërfaqe prej 5994 m2 është paraqitur gjendja faktike e saj, dhe në bazë të përshkrimeve të gjitha pikave dhe koordinatave, ajo duhet të jetë pjesë përbërëse e Aktgjykimit, pasi eksperti ka punuar ekspertizën enkas për

këtë çështje juridike. Tutje paditësit pohojnë se është shumë me rëndësi për gjykatën të dihet se ngastra e cekur në vitin 1969 pa bazë juridike ka kaluar në emër të KBI Progres Export, Prizren, mirëpo paditësit vazhdimisht këtë ngastër e kanë punuar, dhe vazhdojnë ta punojnë pa u penguar nga askush. Tutje ata pohojnë se kjo ngastër kufizohet me prona tjera private, dhe se nuk ka asnjë pengesë që të aprovohet padia si e bazuar, pasi që kjo ngastër nuk ka lidhje me pronë shoqërore. Paditësit në ankesë pretendojnë se dispozitivi i Aktgjykimit është i pakuptueshëm, konfuz dhe nuk mund të qëndrojë. Tutje ata pohojnë se nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, dhe se ka kundërshtim në mes konstatimeve të nxjerra dhe përmbajtjes së dokumenteve, si dhe fakteve të pohuara, dhe kjo sipas tyre është pasojë e vlerësimit të gabuar të provave dhe e mos vërtetimit të fakteve. Tutje paditësit pohojnë se si pasojë e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike gabimisht janë zbatuar edhe dispozitat materiale. Andaj Aktgjykimi i Kolegjit të shkallës së I-rë është i pa qëndrueshëm.

Me datë 02 maj 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen në ankesë. Në përgjigje në ankesë AKP-ja i ka kundërshtuar si të pa bazuara pretendimet ankimore të paditësve, dhe e ka mbështetur në tërësi Aktgjykimin e ankimuar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se ajo mbetet pranë të gjitha thënieve dhe provave të paraqitura në shkallën e I-rë në rastin C-III-17-0029, me të cilat ka kundërshtuar të gjitha pretendimet e paditësve për vërtetim të drejtës së pronësisë për ngastrën lëndore. AKP-ja në këtë parashtresë pohon se paditësit as me ankesë nuk kanë paraqitur ndonjë bazë juridike të besueshme dhe as nuk kanë mundur të konstatojnë ndonjë gjendje tjetër faktike, nga ajo që është vërtetuar me Aktgjykimin e ankimuar. Nga këto arsye, AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësve refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të shkallës së I-rë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Legjitimiteti i kontestuar dhe i pa rregulluar i paditësve

Në rast të një kërkesë (padie) në lidhje me të drejtat pronësore mbi një pasuri të trashëguar, Gjykata duhet të shqyrtojë ex officio nëse të gjithë trashëgimtarët janë të përfaqësuar. Aktvendimi i Trashëgimisë është dokument i vetëm për të treguar dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pozitën trashëgimore, dhe duhet të kërkohej nga paditësit sa më parë që lind ndonjë dyshim, se jo të gjithë trashëgimtarët janë të përfaqësuar si paditës për rastin në fjalë.

Nëse Aktvendimi i Trashëgimisë nuk është paraqitur brenda afatit të arsyeshëm, padia duhet hedhur poshtë si e papranueshme.

Në këtë lëndë Kolegji i Apelit vëren se paditësit nuk e kanë rregulluar çështjen e trashëgimisë lidhur me padinë e tyre të dorëzuar në Gjykatën Komunale në Prizren me datë 24 mars 2006, dhe atë në dy nivele. Paditësit në procedurë në bazë të padisë së tyre paraqiten si nipa dhe mbesa të gjyshit të tyre të ndjerë M2 S, mirëpo në ndërkohë ka vdekur babai i tyre H S, i cili ishte djali i të ndjerit M2 S. Andaj në këtë rast është i nevojshëm jo vetëm Aktvendimi i trashëgimisë për Gjyshin e tyre të ndjerë M2 S, por është i nevojshëm ky aktvendim edhe për prindërin e tyre H S.

Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja në parashtresën e saj të datës 17 tetor 2022, në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 16 janar 2024, sidhe gjatë fjalës përfundimtare me shkrim të dorëzuar me datë 25 janar 2024, vazhdimisht e ka kontestuar mungesën e legjitimitetit aktiv të paditësve në procedurë.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se gjyqtari përgjegjës i lëndës i Kolegjit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, me Urdhrin e datës 22 shtator 2022, i cili ishte pranuar nga Avokati i paditësve me datë 06 tetor 2022, kishte kërkuar nga paditësit të dorëzoj prova për rregullim të legjitimitetit aktiv në procedurë, duke kërkuar pos tjerësh të

dorëzoj aktvdekjen për pasardhësit e tyre të ndjerë dhe Vendimin për shqyrtimin e trashigimisë.

Paditësit me parashtresën e tyre të datës 14 tetor 2022, e kanë dorëzuar Certifikatën e vdekjes dhe Aktvdekjën për të ndjerin H S, por jo ndonjë dëshmi për të ndjerin M2 S. Ata me këtë parashtresë nuk kanë dorëzuar Aktvendimin e Trashigimisë për gjyshin e tyre të ndjerë M2 S, dhe as Aktvendimin e Trashigimisë për babain e tyre të ndjerë H S.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësit as gjatë procedurës ankimore në shkallën e dytë, nuk i kanë dorëzuar Aktvendimet e Trashigimisë për pasardhësit e tyre, megjithëse ata ishin njoftuar se njëra nga bazat ligjore për refuzimin e padisë së tyre, ishte edhe mos rregullimi i legjitimitetit aktiv të tyre në procedurë.

Paditësit kanë pasur kohë të mjaftueshme ta rregullojnë legjitimitetin e tyre aktiv në të dy nivelet, dhe ta sjellin Aktvendimin e trashëgimisë, por ata është e qartë se kanë dështuar të sjellin këtë dokument që është i nevojshëm, madje i domosdoshëm për të rregulluar legjitimitetin e kontestuar aktiv të tyre në procedure.

Paditësit i kanë sjelle certifikata të lindjes dhe të vdekjes dhe akt vdekjen për të ndjerin H S, por me dokumente të tilla të gjendjes civile në bazë nenit 171.1 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore, nuk mund të rregullohet legjitimitetit aktiv i paditësve në procedurë.

Lidhur me meritat e padisë

Kolegji i Apelit vëren se Kolegji i shkallës së I-rë i DHPGJS-së në këtë lëndë është marrë edhe me meritat e padisë së paditësve.

Kolegji i shkallës së I-rë i DHPGJS-së lidhur me meritat e padisë i ka vlerësuar provat e ofruara nga paditësit, dhe ka nxejerrë konstatimet e veta, të cilat si të drejta dhe të bazuara në ligj, i mbështet edhe Kolegji i Apelit.

Kolegji i Apelit vëren se paditësit pretendojnë se që nga viti 1969, prona lëndore e padisë sipas tyre pa bazë ligjore evidentohet në emër të NSH-së së paditur KBI „Progres Export“ në Prizren.

Ekspertiza e ekspertit R S e datës 21 maj 2009, e konfirmon se kjo pronë në bazë të Kontratës së shitëblerjes nr.789/69 ka kaluar nga i ndjeri M2 S në emër të KBI „Proges Export“ në Prizren, por gjithnjë sipas kësaj ekspertize, kjo kontratë nuk është gjetur në kadastër, për shkak të shkatërrimit të dokumentacionit që ka ndodhë për shkak të zjarrit që ka kapluar Drejtorin e Kadastrit në Prizren me datë 29.10.2007.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësit kanë pohuar se ata janë pronar edhe në bazë të Kontratës së shitblerjes, leg nr. të datës . dhjetor., e cila ishte lidhur në mes shitësit F N M nga S e poshtme, dhe blerësit dhe të ndjerit M2 S nga Prizreni.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në deklaratimet e tyre lidhur me këtë pronë ata shfaqen kontradiktor, në njërin anë ato pohojnë se që nga viti 1969, ngastra nr..., evidentohet pa bazë ligjore në emër të Nsh-së së paditur, e në anën tjetër ata pohojnë se ngastrën lëndore e kanë blerë në vitin 1970 nga shitësi F N M nga S e p.

Në këtë lëndë ekziston kjo kontratë, mirëpo kjo kontratë në bazë të vlerësimit të Kolegjit të Apelit, nuk mund të jetë titull i vlefshëm pronësor për të ja njohur paditësve të drejtën e pronësisë. Kjo për faktin se kjo Kontratë nuk është lidhur me NSH-në në emër të cilës ishte prona lëndore në kohën e lidhjes së saj në vitin 1970, por ishte lidhur me një person fizikë, e po ashtu edhe për faktin tjetër se paditësit kanë dështuar të dorëzojnë ndonjë provë materiale, nëse shitësi F N M ishte pronar i kësaj ngastre në vitin 1970, dhe kishte të drejtën e shitjes së kësaj ngastre.

Tutje Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Kolegjit të shkallës së I-rë se paditësit si shfrytëzues të pronës lëndore, nuk janë posedues me mirëbesim, pasi që ata e kanë ditur se prona është në emër të NSH-së si pronë shoqërore, dhe se përmes parashkrimit fitues në bazë të nenit 72 paragrafi 2 të Ligjit për Marrëdhëniet Pronësore Juridike të vitit 1980, nuk ka mundësi tu njihet paditësve e drejta e pronësisë.

Tutje Kolegji i Apelit konstaton se edhe nëse kjo pronë pa bazë ligjore ka kaluar në emër të NSH-së së paditur siç pretendojnë paditësit, ajo në bazë të nenit 268 të Ligjit të Punës së Bashkuar, më nuk mund të kthehet, pasi që kanë kaluar të gjitha afatet ligjore për kthimin e saj, përfshirë afatin prej 10 viteve i përcaktuar me këtë dispozitë ligjore, i cili afat ka rrjedhë nga viti 1969, kur pretendohet se pa bazë ligjore ka kaluar në emër të NSH-së.

Kolegji i Apelit vëren se paditësit në ankesën e tyre pretendojnë se me aktgjykimin e ankimuar janë shkelur dispozitat procedurale dhe dispozitat të së drejtës materiale, dhe se gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë.

Kolegji i Apelit i ka pas në konsideratë këto pretendime ankimore, mirëpo nuk pajtohet me ato pretendime, pasi që janë pretendime të përgjithësuara dhe të pa faktuara, andaj si të tilla kanë mbetur pretendime të pa argumentuara, andaj pretendimet e tilla refuzohen si të pa bazuara.

Tutje shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin e ankimuar ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, në Aktgjykimin i ka dhënë vlerësimet e veta për provat e administruara, duke nxjerrë përfundime të drejta të cilat i mbështet edhe Kolegji i Apelit.

Andaj në bazë të arsyeve të cekura, ankesa e paditësve është refuzuar si e pabazuar, dhe është vërtetuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Paditësi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 20 maj 2024, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Ankesave në DHPGJS, më datë 15 gusht 2024

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues _____